



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “AAB Construction shpk” të datës 29.04.2025 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 24.04.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sanimi i plotë në Hidroizolim, Termoizolim dhe ndërhyrje në xhama në dy faza në Pallatin e Rinisë - Ritender” me nr. të prokurimit 616-24-12853-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “AAB Construction shpk” të datës 29.04.2025 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 24.04.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sanimi i plotë në Hidroizolim, Termoizolim dhe ndërhyrje në xhama në dy faza në Pallatin e Rinisë - Ritender” me nr. të prokurimit 616-24-12853-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “AAB Construction shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 29.04.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 24.04.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sanimi i plotë në Hidroizolim, Termoizolim dhe ndërhyrje në xhama në dy faza në Pallatin e Rinisë - Ritender” me nr. të prokurimit 616-24-12853-5-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

P.1.- "Ne baze të cilit ligj neve jemi eliminuar? Cili nen e ndalon një gjë të tillë? Përgjigja është se asnjë pra kundërligjshëm jemi eliminuar".

P.2.-"GOE DACHGROUP SHPK & NIVA Construction SHPK & HAST Group SHPK për kërkesën e AK në Aneksi 7. pika 4 është kërkuar që të ofrohet cilindër max 4t vibrator me xhemba për ngjeshjen e dheut para vendosjes së themeleve dhe pllave baze, ku në dosje është ofruar vetëm në faturë e cila është shitur nga Rub tek Rexha SHPK, ndërsa nuk ka të dhëna që e deshmojnë që kjo paisje është me peshe max 4t si e tillë kjo paisje nuk e përmbush kërkesën e AK. GOE DACHGROUP SHPK & NIVA Construction SHPK & HAST Group SHPK për kërkesën e AK në Aneksi 7. pika 10 është kërkuar që të ofrohet cisternë karburanti, ndërsa kjo kërkesë nuk është përmbushur pasi që është ofruar marrëveshje me kompaninë, Papenburg që është ofruar paisja 01-893-SR- është një cisternë e ujit jo e karburantit siq është kërkuar, ndërsa është prezantuar edhe dy marrëveshje tjera mirepo asnjëra nga to nuk janë cisterna karburanti pasi që nuk janë prezantuar librezat e qarkullimit për to por vetëm faturat e blerjes ndërsa cisterna e prezantuar e kompanisë Rexha shpk është cisternë ujit dhe jo e karburantit siq është kërkuar. Si e tillë OE është dashur që të eliminohet".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

Ky grup konsiderohet i Papërgjegjshëm, pasi në deklaratën e themelimit të grupit të operatorëve ekonomikë ka deklaruar një peshë përgjegjësie 0 % për anëtarin e grupit, ku është në kundërshtim me përgjegjësitë e anëtarëve të konsorciumit sipas Marrëveshjes - Deklaratës së miratuar nga KRPP të datës 11.11.2024.

Lidhur me pretendimin e parë, duhet theksuar që për parashtruesin nuk është kontestues fakti që anëtari i konsorciumit "triangle shpk" nuk merr pjesë në ekzekutimin e kontratës dhe përqindja e pjesëmarrjes së tij në projekt është zero (0). Përndryshe kjo konfirmohet edhe përmes marrëveshjes së GOE të parashtruesit.

5. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup dhe deklarojmë se % (përqindjen) e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës është:
 - a) [100 % e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës së Liderit-**AAB Construction SHPK**]
 - b) [0 % e pjesëmarrjes në realizimin e kontratës së anëtarit **Triangle SHPK**]
6. **Ne të gjithë anëtarët e grupit** konfirmojmë përgjegjësitë e secilit anëtar:
 - a) [Lideri i Grupit ka përgjegjësi për ekzekutimin e kontratës në përputhje me kushtet dhe specifikimet teknike të përcaktuara në DT]
 - b) [Triangle SHPK -nuk merr pjesë në ekzekutimin e kontratës, por mbështet liderin e grupit me dokumentat për plotësimin e kërkesave të përshtatshmërisë, përshtatshmërisë profesionale, kapacitetit ekonomik dhe financiar, kapacitetin teknik dhe profesional dhe kërkesat tjera konform Njoftimit për kontratë dhe Dosjes së tenderit.]

Përmes nenit 26.15 të RRPP përcaktohet se “Kurdo që Operatorët Ekonomik marrin pjesë si grup, grupi i operatorëve ekonomik së bashku me ofertën e tyre duhet të ofrojnë një Marrëveshje për themelimin e grupit, në të cilën anëtarët e grupit do t’i përcaktojnë të drejtat dhe përgjegjësitë, si dhe të gjitha veprimet procedurale që duhet t’i kryej lideri i grupit në emër të grupit. Autoritetet Kontraktuese duhet të vendosin këtë kërkesë në Dosjen e Tenderit, si dhe formën standarde të marrëveshjes të hartuar dhe miratuar nga KRPP”. Ndërsa në formularin e marrëveshjes së KRPP në pikën 1 deklarohej se të gjithë anëtarët e GOE janë përgjegjës për ekzekutimin e kontratës. Më konkretisht thuhet se “Ne të gjithë anëtarët e grupit jemi bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës”. Ndërsa në pikën 2 dhe 5 rikonfirmohet se të gjithë anëtarët janë pjesëmarrës në grup. Më konkretisht thuhet se “Ne të gjithë anëtarët e grupit konfirmojmë pjesëmarrjen tonë në grup...”. Ndërsa në marrëveshjen e dorëzuar thuhet që anëtari “Triangle shpk” nuk merr pjesë në ekzekutimin e kontratës që nënkupton se nuk është pjesë e grupit përkatësisht ka zero (0) përgjegjësi në grup. Paradoksalisht parashtruesi në të njëjtën kohë në marrëveshje deklaroi se do të shfrytëzoj vetëm dokumentet e OE “Triangle shpk” por punën do t’a realizoj vetë. Fillimisht deklarata e hapur e parashtruesit ku thuhet që anëtari do të shfrytëzohet vetëm për të prezantuar dokumentet e tij për të përmbushur kërkesat lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional dhe kërkesat tjera të DT, mirëpo i njëjti nuk do të merr pjesë në ekzekutimin e kontratës si anëtar i GOE, përbën deklaratë jo vetëm kundërtënëse por edhe të pabazuar në ligj. Në anën tjetër është i pakontestueshëm fakti që një OE me zero (0) përgjegjësi në GOE nuk është fare anëtar i GOE. Rrjedhimisht i njëjti përderisa nuk ka asnjë përgjegjësi në GOE nuk ka përgjegjësi as për të prezantuar dokumentet e tij në procedurën e prokurimit. Prandaj marrëveshja e tillë e parashtruesit është në kundërshtim të plotë me nenin 26.15 të RRPP. Po ashtu marrëveshja është në kundërshtim edhe me nenin 71 par. 3 të LPP ku thuhet se “...nëse kontrata përkatëse i epet grupit në fjalë, ata gjithashtu janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë”. Në rastin konkret anëtari Triangle shpk ka deklaruar se në rast të dhënies së kontratës ai nuk do të merr fare pjesë në ekzekutimin e kontratës as së bashku dhe as veçmas. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit ndërsa të gjitha pretendimi ankimor është i pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimin e dytë, përderisa oferta e parashtruesit është jo vetëm e papërgjegjshme por edhe më e shtrenjtë sesa oferta e tenderuesit të rekomanduar, është gjetur se parashtruesi nuk është fare palë e interesuar në raport me këtë pretendim pasi që nuk kanë asnjë interes material nga cilido rezultat që mund të arrihet nga ky këndvështrim dhe në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP ku përcaktohet se “personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”. Përtej këtij fakti, janë konfirmuar të gjeturat e komisionit vlerësues sipas të cilave tenderuesi i rekomanduar ka përmbushur të gjitha

kërkesat e DT duke përfshirë edhe pajisjet që po kontestohen nga parashtruesi të cilat janë prezantuar nga tenderuesi i rekomanduar ashtu sikurse janë kërkuar me DT. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 05.05.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.